



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 549/005
Dt 06.04.2018

Në bazë të nenit 38, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbyesit civilë, nenit 20, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.2, dhe nenit 21 paragrafi 2, pika 2.1 dhe paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e shërbyesve civilë, si dhe nenit 23, paragrafi 1, pika 1.6.2 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, në mbledhjen e mbajtur më 30.3.2018, mori:

VENDIM

- I. Aprovohet kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për nëpunësit civilë të Universitetit të Mitrovicës, të cilët përveç detyrave të tyre angazhohen edhe për kryerjen e punëve të nëpunëseve që janë në pushim të lehonisë.
- II. Nëpunësve civilë nga pika I e këtij vendimi u takon kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt vetëm për periudhën e zëvendësimit të një nëpunëseje që ndodhet në pushim të lehonisë dhe atë, jo më shumë se për 40 orë në muaj për punë jashtë orarit të rregullt të punës, përkatësisht 30% shtesë të pagës bazë të nëpunëses që e zëvendësojnë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.
- III. Kërkesa për zëvendësimin e një nëpunëseje që ndodhet në pushim të lehonisë duhet të jetë e autorizuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- IV. Nëpunësit civilë nga pika I e këtij vendimi janë të obliguar që të dorëzojnë raporte mujore për punën jashtë orarit të rregullt të punës.
- V. Obligohet zyrtari i personelit për zbatimin e këtij vendimi në bazë kërkesës së autorizuar dhe raporteve mujore për punën jashtë orarit të rregullt të nënshkruar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, pasi shqyrtoi kërkesën e dekanit të FIMK-ut për lejjimin e kompensimit të punës shtesë jashtë orarit për Vjosa Jetullahun, e cila përveç detyrave të saj është e angazhuar edhe në kryerjen e punëve të dy zyrtareve që ndodhen në pushim të lehonisë, e konsideroi si të arsyeshme dhe të bazuar në ligj kërkesën, për arsye se buxheti për paga dhe mëditje për nëpunëset që janë apo shkojnë në pushime të lehonisë janë të parapara në buxhetin e planifikuar për vitin 2018 e në vijim, në bazë të numrit të të punësuarve, mirëpo kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt mund të bëhet vetëm për periudhën e zëvendësimit të një nëpunëseje që ndodhet në pushim të lehonisë. Bazuar në këto që u cekën, si dhe bazuar në nenin 38, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbyesit civilë, nenin 20, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.2, dhe nenin 21 paragrafi 2, pika 2.1 dhe paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e shërbyesve civilë, si dhe nenin 23, paragrafi 1, pika 1.6.2 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Drejtorëve të UMIB-it;
5. Zyrtarit të personelit.



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Dr. sc. Sabri Sadiku